



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.227/11 prot.

Datë 29.02.2024

V E N D I M
Nr. 233 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 188/2024, datë 16.02.2024 për procedurën e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar- shërbime” me Nr. REF-93973-01-24-2024, me objekt “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) leke, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durrës sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK me NIPT L82210031Q dhe me adresë Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati “Viridario 1” Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale “Ujësjellës Kanalizime Durrës” Sh.A.
Adresa: L.17 Rr. “Dalip Peza”.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 16.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.188/2024, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar- shërbime” me Nr. REF-93973-01-24-2024, me objekt “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) leke, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durrës sh.a*
 2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK për modifikim të dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.*
 3. *Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
 4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
 5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Nexia AL Consulting” SHPK.*
 6. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 17/11 prot., datë 23.02.2024, protokolluar me tonën nr. 227/8 prot., datë 26.02.2024, autoriteti kontraktor, njofton se: *“Referuar Vendimit 188/2024 datë 16.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 36/26 prot., datë 21.02.2024, në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) leke, pa TVSH, me Nr. REF-93973-01-24-2024, ju bëjmë me dije se Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durrës Sh.A në cilësinë e autoritetit kontraktor ka ngarkuar një shtojcë në SPE me ndryshime në përputhje me konstatimet dhe vendimin 188/2024 datë 16.02.2024 të KPP-së”.*

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 17/11 prot., datë 23.02.2024, protokolluar me tonën nr. 227/8 prot., datë 26.02.2024, autoriteti kontraktor, njofton se: *“Referuar Vendimit 188/2024 datë 16.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 36/26 prot., datë 21.02.2024, në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK për*

procedurën e prokurimit me objekt “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) leke, pa TVSH, me Nr. REF-93973-01-24-2024, ju bëjmë me dije se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A në cilësinë e autoritetit kontraktor ka ngarkuar një shtojcë në SPE me ndryshime në përputhje me konstatimet dhe vendimin 188/2024 datë 16.02.2024 të KPP-së”.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit, nëpërmjet një shtojcë për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, dhe e ka publikuar, e cila është në përputhje me vendimin Nr. 188/2024, datë 16.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Autoriteti i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A, ka zbatuar vendimin Nr. 188/2024, datë 16.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit prokurimit “E Hapur e thjeshtuar- shërbime” me Nr. REF-93973-01-24-2024, me objekt “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore” me fond limit 3,996,000 (Tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) leke, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

